

REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

PROGRAMI
I KURSIT TË UNIFIKUAR
“PARUKERI”

Kodi: PK-AA-1-24

Miratoi:

MINISTRI

.....

Tiranë, 2024

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

“PARUKERI”

(PK-AA-1-24)

I. Profili Profesional i parukierit

a) Karakteristikat e parukierit

Parukieri është i aftë të kryejë **detyra** profesionale si i punësuar apo i vetpunësuar në biznese që ofrojnë shërbime parukerie.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, parukieri duhet që të zotërojë **njohuri** profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë të parukerisë, si dhe **shprehi** profesionale që lidhen me veprimtarinë profesionale të parukerisë.

Suksesi i parukierit është i lidhur ngushtë dhe me **sjellje** (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, përkujdesja, komunikimi, përqendrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, disiplina etj, sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe të përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e parukierit

Profesioni i parukierit është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për larje, lyerje, prerje, krehje, stilim dhe trajtim të flokëve, si dhe këshillim të klientëve. Ai mund të punësohet në parukeri, sallone bukurie dhe biznese apo veprimtari që kërkojnë shërbime parukerie, si dhe mund të vetëpunësohen për të ofruar këto shërbime.

Një individ mund të ushtrojë profesionin e parukierit fillimisht si ndihmës parukier. Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e parukierit të kualifikuar. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimit nëpërmjet punës, një parukier mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës si menaxher i një salloni bukurie.

Për të zhvilluar aktivitet privat në sektorin e parukerisë, duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësinë “Parukierë, berberë”, me kod 5141, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si: berber, parukier për studio apo parukier për skenë etj.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për parukeri

Në përfundin të Kursit për parukeri, kursantët do të jenë të aftë të:

- kryejnë organizimin e punës në sallon parukerie;
- presin klientin në vendin e punës;
- përdorin katalogë të ndryshëm, në format fizik dhe elektronik;
- diskutojnë me klientët për kërkesat e tyre;
- plotësojnë kartën e klientit;
- kryejnë larje të flokëve;
- kryejnë prerje të flokëve;
- lyejnë flokët me bojëra flokësh
- japin forma të ndryshme flokëve;

- drejtojnë flokët me keratinë;
- realizojnë stilime të ndryshme të flokëve;
- kryejnë trajtime të ndryshme të flokëve;
- ofrojnë këshilla për klientët;
- përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës;
- përdorin dhe mirëmbajnë mjetet e punës;
- kryejnë llogaritje ekonomike të thjeshta dhe veprime për pagesat;
- komunikojnë me etikë profesionale;
- zbatojnë rregullat e higjienës personale dhe të vendit të punës;
- zbatojnë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin për parukeri.

Pjesëmarrësit në Kursin për parukeri duhet të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e Kursit për parukeri

360 orë mësimore, ku
1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për parukeri

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet e të Nxënit
1	Hyrje në profesionin e parukerisë	MK-32-121-24	28 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të parukerisë. 2. Kursanti përshkruan mjedisin, veglat, pajisjet dhe materialet e punës së parukierit. 3. Kursanti përshkruan rregullat e etikës, të higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit në parukeri. 4. Kursanti përshkruan llojet dhe karakteristikat e flokëve.
2	Prerja e flokëve	MK-32-122-24	84 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e prerjes së flokëve. 2. Kursanti realizon larjen dhe trajtimin e flokëve për prerje. 3. Kursanti realizon prerje të ndryshme.
3	Krehjet e flokëve	MK-32-376-24	64 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e krehjes së flokëve. 2. Kursanti realizon larjen dhe tharjen e flokëve. 3. Kursanti realizon krehje me modele të ndryshme.

4	Stilimet e flokëve	MK-32-377-24	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e stilimeve të flokëve. 2. Kursanti realizon larjen dhe përgatitjen e flokëve për stilim. 3. Kursanti realizon stilime dhe zgjatime të flokëve.
5	Permanenti i flokëve	MK-32-124-23	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e permanentit të flokëve. 2. Kursanti lan dhe përgatit klientin për permanentin e flokëve. 3. Kursanti realizon lloje të ndryshme të permanentit të flokëve dhe drejtimit të flokëve me keratinë.
6	Lyerja e flokëve	MK-32-125-24	84 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori 70% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e lyerjes së flokëve. 2. Kursanti realizon lyerjen e flokëve. 3. Kursanti realizon ç'ngjyrosjen (dekolorimin) dhe ringjyrosjen e flokëve. 4. Kursanti realizon ngjyrosjen e flokëve me fije.

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet e të Nxënit që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MEKI.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për parukeri:

1. Moduli “Hyrje në profesionin e parukerisë”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E PARUKERISË	MK-32-121-24
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e profesionit të parukierit, me mjedisin dhe mjetet e punës së parukierit, me rregullat e etikës, të higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit, si dhe me llojet dhe karakteristikat e flokëve të njeriut.	
Kohëzgjatja e modulit	28 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të parukierit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë qëllimin dhe rëndësinë e shërbimeve të parukerisë për individin; - të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës së parukierit; - të përshkruajë mjediset, mënyrën e organizimit dhe kushtet e punës së parukierit; - të përshkruajë mjetet, pajisjet dhe makineritë që përdor parukieri; - të përshkruajë proceset kryesore të veprimtarisë së parukierit; - të tregojë organizimin e punës në një parukeri; - të tregojë organizimin e grafikut të takimeve për shërbimet e parukerisë; - të përshkruajë bazën e të dhënave të klientit; - të përshkruajë kërkesat profesionale për parukierin; - të tregojë mundësitë e punësimit dhe të karrierës profesionale të parukierit; - të përshkruajë kuadrin ligjor të veprimtarisë së parukerisë; - të përshkruajë kërkesat për liçensim për ushtrimin e veprimtarisë së parukerisë. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë. - Pyetje - përgjigje me shkrim. RN 2 Kursanti përshkruan mjedisin, veglat, pajisjet dhe materialet e punës së parukierit. Kriteret e vlerësimit:	

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë mjedisin e punës në parukeri;
- të organizojë dhe mirëmbajë mjedisin e punës në parukeri;
- të përshkruajë dhe të dallojë veglat, mjetet dhe pajisjet e punës së parukierit;
- të tregojë përdorimet e veglave, mjeteve dhe pajisjeve të punës së parukierit;
- të mirëmbajë veglat, mjetet dhe pajisjet e punës së parukierit;
- të dallojë dhe tregojë përdorimet e materialeve të punës në veprimtarinë e parukierit;
- të interpretojë etiketat dhe udhëzimet e prodhuesit për materialet e punës së parukierit;
- të sistemojë dhe mirëmbajë materialet e punës së parukierit;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RN 3 Kursanti përshkruan rregullat e etikës, të higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit në parukeri.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë veçoritë e tipeve të ndryshme të klientëve në parukeri;
- të dallojë tipet e ndryshme të klientëve;
- përshkruajë rregullat e komunikimit me etikë profesionale me klientët, eprorët, kolegët etj;
- të përshkruajë dhe të zbatojë rregullat e higjienës personale;
- të përshkruajë dhe të zbatojë rregullat e higjienës së klientit, mjedisit dhe mjeteve të punës;
- të përshkruajë dhe të zbatojë rregullat e sigurisë së klientit dhe të mjedisit të punës;
- të përshkruajë dhe të zbatojë rregullat e mbrojtjes nga zjarri, nga rryma elektrike dhe nga rreziqe të tjera;
- të përshkruajë dhe të zbatojë rregullat e ruajtjes dhe përdorimit të materialeve dhe mjeteve të parukerisë;
- të tregojë përdorimin e kutisë së ndihmës së shpejtë dhe mënyrën e dhënies së ndihmës së parë për të dëmtuarit;
- të përshkruajë dhe të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit të punës në parukeri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Kursanti përshkruan llojet dhe karakteristikat e flokëve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë ndërtimin e brendshëm të fijes së flokëve;
- të përshkruajë anatomicën e flokëve dhe skalpit të kokës;
- të përshkruajë funksionet fiziologjike dhe estetike të flokëve dhe skalpit të kokës;
- të përshkruajë karakteristikat e fijes së flokëve si ngjyra, trashësia, forma, dendësia, gjatësia etj;
- të përshkruajë llojet e flokëve dhe karakteristikat e tyre;
- të dallojë llojet e flokëve;
- të përcaktojë llojin e flokëve në bazë të përpunimeve kozmetike që i është nënshtruar më parë;
- të analizojë modelet tipike të flokëve dhe veçoritë e tyre.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së parukerisë. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të parukerisë.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në parukeri. Atyre duhet t'i jepen detyra të ndryshme që të vëzhgojnë dhe analizojnë mjedisin, mjetet dhe veprimtaritë ku mbështetet puna e parukierit. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive në lidhje me veçoritë e profesionit të parukierit, me mjedisin dhe mjetet e punës së parukierit, me rregullat e etikës, të higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit, si dhe me llojet dhe karakteristikat e flokëve të njeriut.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës në parukeri.
 - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në parukeri.
 - Manikinë parukerie.
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

2. Moduli “Prerja e flokëve”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PRERJA E FLOKËVE	MK-32-122-24
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e dhe procedurat e prerjes së flokëve, si dhe i aftëson ata që të kryejnë proceset e larjes dhe prerjes.	
Kohëzgjatja e modulit	84 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulin “Hyrje në profesionin e parukerisë”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan veçoritë e prerjes së flokëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë procedurat kryesore për të realizuar prerjen e flokëve; - të argumentojë qëllimin dhe rëndësinë që ka prerja e flokëve në parukeri; - të tregojë mjetet për prerjen e flokëve dhe përdorimet e tyre; - të përshkruajë veçoritë e llojeve të ndryshme të prerjes së flokëve; - të përshkruajë prerjet bazë të flokëve; - të analizojë faktorët që merren parasysh për të përzgjedhur llojin e prerjes së flokëve të klientit; - të përshkruajë llojet e fytyrave dhe të përshtatë prerjen e flokëve në varësi të tyre; - të përshkruajë rregullat e komunikimit me klientin; - të përshkruajë masat e higjienës për prerjen e flokëve. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë. - Pyetje - përgjigje me shkrim. RN 2 Kursanti realizon larjen dhe trajtimin e flokëve për prerje. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të marrë informacion paraprak nga klienti; - të orientojë klientin në bazë të kërkesave të tij; - të analizojë llojin dhe gjendjen e flokëve të klientit; - të përgatisë dhe pozicionojë klientin për larjen dhe trajtimin e flokëve për prerje; - të përzgjedhë veglat dhe mjetet për larjen dhe trajtimin e flokëve për prerje; - të përzgjedhë produktet e duhura në varësi të flokëve; - të përcaktojë procedurat e larjes dhe trajtimit të flokëve për prerje;	

- të realizojë larjen e flokëve për prerje;
- të trajtojë flokët me produktet përkatëse (maska, ampula, botoks etj);
- të kryejë llogaritje ekonomike të thjeshta për shërbimet e kryera;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti realizon prerje të ndryshme.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të marrë informacion paraprak nga klienti;
- të orientojë klientin në bazë të kërkesave të tij;
- të përgatisë dhe pozicionojë klientin për prerjen e flokëve;
- të analizojë llojin dhe gjendjen e flokëve të klientit;
- të përzgjedhë veglat dhe mjetet për prerjen e flokëve;
- të përcaktojë llojin e prerjes së flokëve, në bashkëpunim me klientin;
- të përcaktojë procedurat e prerjes së flokëve;
- të realizojë ndarjen e flokëve në seksione;
- të realizojë prerjen e drejtë ose 0 gradë;
- të realizojë prerjen me shkallëzim 45 gradë;
- të realizojë prerjen me shkallëzim 90 gradë;
- të realizojë prerjen me shkallëzim mbi 90 gradë;
- të realizojë prerjen me shkallëzim 180 gradë;
- të realizojë prerjen 30 gradë;
- të realizojë prerjen kapelon;
- të realizojë prerjen e thjeshtë;
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet për prerjen e flokëve;
- të kryejë llogaritje ekonomike të thjeshta për shërbimet e kryera;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së parukerisë. Rekomandohen dhe vizita dhe praktika në biznese që kryejnë veprimtari të parukerisë.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli. Rekomandohet të përdoren metodat e lojës me

	role dhe e simulimit. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në parukeri. Atyre duhet t'i jepen detyra praktike për larjen dhe trajtimin për prerje, prerjen dhe stilimin e flokëve, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul, si procedurat e prerjes së flokëve, aftësimi i tyre që të kryejnë proceset e larjes dhe prerjes së flokëve. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale të punës në parukeri. - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës për larjen, trajtimin dhe prerjen e flokëve në parukeri. - Mjete dhe pajisje prerëse të flokëve. - Manikinë të ndryshëm. - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesat, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

3. Moduli “Krehjet e flokëve”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	KREHJET E FLOKËVE	MK-32-376-24
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e dhe procedurat e krehjes së flokëve, si dhe i aftëson ata që të kryejnë proceset e larjes, tharjes, krehjes.	
Kohëzgjatja e modulit	64 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulin “Hyrje në profesionin e parukerisë”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan veçoritë e krehjes së flokëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë procedurat kryesore për të realizuar krehjen e flokëve; - të përshkruajë rëndësinë që ka krehja e flokëve në parukeri; - të tregojë mjetet për krehjen e flokëve dhe përdorimet e tyre; - të përshkruajë veçoritë e llojeve të ndryshme të krehjes dhe të flokëve; - të përshkruajë krehjet bazë të flokëve; - të përshkruajë faktorët që merren parasysh për të përzgjedhur llojin e krehjes së flokëve të klientit; - të dallojë format e fytyrave dhe të përshtatë krehjen e flokëve në varësi të tyre; - të përshkruajë rregullat e komunikimit me klientin; - të përshkruajë masat e higjienës për krehjen e flokëve. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli. - Pyetje - përgjigje me gojë. RN 2 Kursanti realizon larjen dhe tharjen e flokëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : - të marrë informacion paraprak nga klienti; - të orientojë klientin në bazë të kërkesave të tij; - të analizojë llojin dhe gjendjen e flokëve të klientit; - të përzgjedhë materialet, veglat dhe mjetet për larjen dhe tharjen e flokëve; - të përgatisë dhe pozicionojë klientin për larjen dhe tharjen e flokëve; - të përcaktojë procedurat e larjes dhe tharjes së flokëve;	

- të realizojë procedurën e larjes së flokëve;
- të përgatitë klientin për tharjen e flokëve;
- të realizojë procedurën e tharjes së flokëve;
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet për larjen dhe tharjen e flokëve;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje - përgjigje me gojë.

RN 3 Kursanti realizon krehje me modele të ndryshme.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të marrë informacion paraprak nga klienti;
- të orientojë klientin në bazë të kërkesave të tij;
- të analizojë llojin dhe gjendjen e flokëve të klientit;
- të përcaktojë modelin e krehjes, në bashkëpunim me klientin;
- të përzgjedhë materialet, veglat dhe mjetet për krehjen e flokëve;
- të përgatisë dhe pozicionojë klientin për krehjen e flokëve;
- të përcaktojë procedurat e krehjes së flokëve;
- të realizojë ndarjen e seksioneve;
- të realizojë krehjen e flokëve me difuzor;
- të realizojë krehje të ndryshme me furçë, piastër, mashë;
- të realizojë onde me bikudina forme;
- të kryejë llogaritje ekonomike të thjeshta për shërbimet e kryera;
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet për krehjen e flokëve;
- të kryejë regjistrimin e shërbimeve të kryera për klientin;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje - përgjigje me gojë.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së parukerisë. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të parukerisë.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli. Rekomandohet të përdoren metodat e lojës me role dhe e simulimit.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në parukeri. Atyre duhet t'i jepen detyra

	praktike për stilimet dhe zgjatjen e flokëve, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul, veçorive dhe procedurave të krehjes së flokëve, si dhe i aftëson ata që të kryejnë proceset e larjes, tharjes, krehjes. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale të punës në parukeri. - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës për larjen, tharjen dhe krehjen e flokëve në parukeri. - Mjete dhe pajisje për larjen, tharjen dhe krehjen e flokëve. - Manikinë të ndryshëm. Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

4. Moduli “Stilimet e flokëve”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	STILIMET E FLOKËVE	MK-32-377-24
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë dhe procedurat e stilimeve të flokëve.	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulin “Hyrje në profesionin e parukerisë”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan veçoritë e stilimeve të flokëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë rëndësinë që kanë stilimet i flokëve në parukeri; - të përshkruajë procedurat kryesore për të realizuar stilimet e flokëve; - të tregojë mjetet për stilimet e flokëve dhe përdorimet e tyre; - të përshkruajë veçoritë e llojeve të ndryshme të stilimeve të flokëve; - të përshkruajë stilimet bazë të flokëve; - të përshkruajë faktorët që merren parasysh për të përzgjedhur llojin e stilit të flokëve të klientit; - të dallojë format e fytyrave dhe të përshtatë stilimet e flokëve në varësi të tyre; - të përshkruajë rregullat e komunikimit me klientin; - të përshkruajë masat e higjienës për stilimet e flokëve. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli. - Pyetje - përgjigje me gojë. RN 2 Kursanti realizon larjen dhe përgatitjen e flokëve për stilim. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të marrë informacion paraprak nga klienti; - të orientojë klientin në bazë të kërkesave të tij; - të analizojë llojin dhe gjendjen e flokëve të klientit; - të përzgjedhë materialet, veglat dhe mjetet për larjen dhe stilimin e flokëve; - të përgatisë dhe pozicionojë klientin për larjen dhe stilimin; - të përcaktojë procedurat e larjes së flokëve për stilim; - të realizojë procedurën e larjes së flokëve;	

- të përgatitë flokët e klientit për stilim ;
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet për larjen dhe stilimin e flokëve;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje - përgjigje me gojë.

RN 3 Kursanti realizon stilime dhe zgjatime të flokëve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të marrë informacion paraprak nga klienti;
- të orientojë klientin në bazë të kërkesave të tij;
- të analizojë llojin dhe gjendjen e flokëve të klientit;
- të përcaktojë llojin e stilit dhe zgjatimit të flokëve, në bashkëpunim me klientin;
- të përzgjedhë materialet, veglat dhe mjetet për stilimin dhe zgjatimin e flokëve;
- të përgatisë dhe pozicionojë klientin për stilimin dhe zgjatimin e flokëve;
- të përcaktojë procedurat e stilit dhe zgjatimit të flokëve;
- të realizojë ndarjen e flokëve në seksioneve;
- të realizojë gërsheta të ndryshme;
- të realizojë stilimet bazë (banana, fiongo etj);
- të realizojë stilime klasike, moderne, etj;
- të realizojë zgjatime të flokëve me kapëse dhe keratinë;
- të kryejë llogaritje ekonomike të thjeshta për shërbimet e kryera;
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet për stilimin dhe zgjatimin e flokëve;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së parukerisë. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të parukerisë.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli. Rekomandohet të përdoren metodat e lojës me role dhe e simulimit.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në parukeri. Atyre duhet t'i jepen detyra praktike për stilimet dhe zgjatjen e flokëve, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.

	- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul, veçoritë dhe procedurat e stilimeve të flokëve. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale të punës në parukeri. - Komploti i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës për stilimet dhe zgjatimin e flokëve në parukeri. - Mjete dhe pajisje stiluese dhe zgjatuese të flokëve. - Manikinë të ndryshëm. Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

5. Moduli “Permanentit të flokëve”.

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PERMANENTI I FLOKËVE	MK-32-124-24
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë dhe procedurat e permanentit të flokëve, si dhe i aftëson ata që të kryejnë proceset e larjes dhe bërjes së permanentit të flokëve të ndryshëm.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulin “Hyrje në profesionin e parukerisë”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan veçoritë e permanentit të flokëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë rëndësinë që ka procesi i permanentit në parukeri; - të përshkruajë procedurat kryesore për të realizuar permanentin e flokëve; - të tregojë mjetet për permanentin e flokëve dhe përdorimet e tyre; - të përshkruajë veçoritë e llojeve të ndryshme të permanentit të flokëve; - të analizojë faktorët që konsiderohen për të përzgjedhur llojin e permanentit të flokëve të klientit; - të dallojë format e fytyrave dhe të përshtatë permanentin e flokëve në varësi të tyre; - të përshkruajë masat e higjienës për realizimin e permanentit të flokëve. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli. - Pyetje - përgjigje me gojë RN 2 Kursanti lan dhe përgatit klientin për permanentin e flokëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të marrë informacion paraprak nga klienti; - të orientojë klientin në bazë të kërkesave të tij; - të analizojë llojin dhe gjendjen e flokëve të klientit; - të përgatisë dhe pozicionojë klientin për larjen e flokëve për permanent; - të përzgjedhë produktet e duhura për larjen flokëve; - të përcaktojë procedurat e larjes së flokëve për permanent; - të realizojë larjen e flokëve për permanent; - të përgatisë klientin për permanentin e flokëve;	

- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti realizon lloje të ndryshme të permanentit të flokëve dhe drejtimit të flokëve me keratinë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të marrë informacion paraprak nga klienti;
- të orientojë klientin në bazë të kërkesave të tij;
- të analizojë llojin dhe gjendjen e flokëve të klientit;
- të përcaktojë llojin e permanentit që do të kryhet, në bashkëpunim me klientin;
- të për zgjedhë materialet, veglat dhe mjetet për permanentin e flokëve;
- të përgatisë dhe pozicionojë klientin për permanentin e flokëve;
- të realizojë ndarjen e flokëve në seksione, sipas llojit të permanentit;
- të realizojë permanentin standard, për të gjitha llojet e flokëve;
- të realizojë permanentin tradicional (në formë tulle);
- të realizojë permanentin spiral për flokë të gjatë;
- të realizojë permanentin voluminoz për flokë të gjatë;
- të fiksojë flokët pas permanentit me produktet përkatëse;
- të realizojë tharjen e flokëve me difuzor;
- të realizojë drejtimin e flokut me keratinë;
- të këshillojë klientin për mirëmbajtjen e permanentit të flokëve;
- të kryejë llogaritje ekonomike të thjeshta për shërbimet e kryera;
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet për permanentin e flokëve;
- të regjistrojë shërbimet e kryera për klientin (karta e klientit);
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje - përgjigje me gojë.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së parukerisë. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të parukerisë.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me

	objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli. Rekomandohet të përdoren metodat e lojës me role dhe e simulimit. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në parukeri. Atyre duhet t'i jepen detyra praktike për larjen e flokëve dhe realizimin llojeve të ndryshme të permanentit të tyre, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul, veçoritë dhe procedurat e permanentit të flokëve, si dhe i aftëson ata që të kryejnë proceset e larjes dhe bërjes së permanentit të flokëve të ndryshëm. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale të punës në parukeri. - Komploti i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës për larjen, tharjen dhe permanentin e flokëve në parukeri. - Mjete dhe pajisje larëse, tharëse dhe permanentin e flokëve. - Manikinë të ndryshëm. - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

6. Moduli “Lyerja e flokëve”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	LYERJA E FLOKËVE	MK-32-125-24
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë dhe procedurat e lyerjes së flokëve, si dhe i aftëson ata që të kryejnë proceset e lyerjes së flokëve të ndryshëm.	
Kohëzgjatja e modulit	84 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori; 70% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulin “Hyrje në profesionin e parukerisë”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Kursanti përshkruan veçoritë e lyerjes së flokëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë qëllimin, rëndësinë dhe historikun e lyerjes së flokëve në parukeri; - të përshkruajë procedurat dhe rregullat kryesore për të realizuar lyerjen e flokëve; - të tregojë mjetet dhe pajisjet për lyerjen e flokëve dhe përdorimet e tyre; - të dallojë ngjyrat (parësore, dytësore, tretësore); - të dallojë produktet (oksikrem, serume etj), karakteristikat dhe përdorimet e tyre për lyerjen e flokëve; - të përshkruajë veçoritë e llojeve të ndryshme të lyerjes së flokëve; - të përshkruajë faktorët që merren parasysh për të përzgjedhur llojin e lyerjes së flokëve të klientit; - të përshkruajë llojet e fytyrave dhe modelet e flokëve, si dhe të përshtatë lyerjen e flokëve në varësi të tyre; - të përshkruajë masat e higjienës dhe të sigurisë për realizimin e lyerjes së flokëve. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli. - Pyetje - përgjigje me gojë
	RN 2	Kursanti realizon lyerjen e flokëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të marrë informacion paraprak nga klienti; - të orientojë klientin në bazë të kërkesave të tij; - të analizojë llojin, gjendjen dhe lyerjet e mëparshme të flokëve të klientit; - të përcaktojë llojin dhe ngjyrën e flokëve që do të lyhen, nisur nga përqindja e flokëve të thinjur, si dhe në bashkëpunim me klientin;

- të përgatisë dhe pozicionojë klientin për lyerjen e flokëve;
- të kryejë testin e alergjisë nga boja;
- të përzgjedhë veglat dhe mjetet për lyerjen e flokëve;
- të përzgjedhë bojrat dhe produktet e duhura në varësi të llojit dhe ngjyrës së lyerjes së flokëve;
- të përcaktojë procedurat e lyerjes së flokëve;
- të përcaktojë oksikremin që do përdorë;
- të parapërgatisë flokët për lyerje;
- të realizojë ndarjen e seksioneve për lyerjen;
- të kryejë lyerjen e rrënjës së flokëve;
- të kryejë lyerjen e gjatësisë së flokëve;
- të kryejë lyerjen totale të flokëve;
- të lajë flokët pas lyerjes, me shampoon e duhur;
- të trajtojë flokët pas lyerjes me produktet e duhura (maska, ampula etj);
- të këshillojë klientin për mirëmbajtjen e flokëve të lyer në vijimësi;
- të kryejë llogaritje ekonomike të thjeshta për shërbimet e kryera;
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet për lyerjen e flokëve;
- të regjistrojë shërbimet e kryera të klientit (karta e klientit);
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti realizon ç`ngjyrosjen (dekolorimin) dhe ringjyrosjen e flokëve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të marrë informacion paraprak nga klienti;
- të orientojë klientin në bazë të kërkesave të tij;
- të analizojë llojin, gjendjen dhe procedurat e mëparshme të kryera te flokët e klientit;
- të përcaktojë shkallën e fortësisë së çeljes së flokëve;
- të përcaktojë llojin dhe procedurat e ç`ngjyrosjen (dekolorimin), në bashkëpunim me klientin;
- të përgatisë dhe pozicionojë klientin për ç`ngjyrosjen (dekolorimin) dhe ngjyrosjen e flokëve;
- të përzgjedhë produktet dhe mjetet e duhura për ç`ngjyrosjen (dekolorimin) dhe ngjyrosjen e flokëve;
- të kryejë parapërgatitjen e flokëve për ç`ngjyrosje dhe ngjyrosjen e flokëve;
- të kryejë ç`ngjyrosjen (dekolorimin) e flokëve;
- të kryejë ngjyrosjen e flokëve;
- të këshillojë klientin për mirëmbajtjen e flokëve në

- vijimësi;
- të kryejë llogaritje ekonomike të thjeshta për shërbimet e kryera;
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet për ç'ngjyrosjen dhe ngjyrosjen e flokëve;
- të regjistrojë shërbimet e kryera të klientit (karta e klientit);
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Kursanti realizon ngjyrosjen e flokëve me fije.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të marrë informacion paraprak nga klienti;
- të orientojë klientin në bazë të kërkesave të tij;
- të përcaktojë llojin, gjendjen dhe lyerjet e mëparshme të flokëve të klientit;
- të përcaktojë llojin dhe procedurën e ngjyrosjes me fije të flokëve në bashkëpunim me klientin;
- të përgatisë dhe pozicionojë klientin për ngjyrosjen e flokëve me fije;
- të për zgjedhë produktet dhe mjetet e duhura për ngjyrosjen e flokëve me fije;
- të parapërgatisë flokët për fije;
- të realizojë fijet me letër alumini, kapuç etj;
- të ngjyrosë fijet e çelura;
- të kryejë larjen dhe trajtimin e flokëve, pas ngjyrosjes me fije;
- të këshillojë klientin për mirëmbajtjen e flokëve në vijimësi;
- të kryejë llogaritje ekonomike të thjeshta për shërbimet e kryera;
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet për ngjyrosjen me fije të flokëve;
- të regjistrojë shërbimet e kryera të klientit (karta e klientit);
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së parukerisë. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të parukerisë.

-
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli. Rekomandohet të përdoren metodat e lojës me role dhe e simulimit.
 - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në parukeri. Atyre duhet t'i jepen detyra praktike për lyerjen, ç'ngjyrosjen, ringjyrosjen dhe ngjyrosjen me fije të flokëve, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
 - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul, procedurat e lyerjes së flokëve, si dhe i aftëson ata që të kryejnë proceset e lyerjes së flokëve të ndryshëm.
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës në parukeri.
 - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës lyerjen, ç'kolorimin dhe ngjyrosjen me fije të flokëve në parukeri.
 - Mjete dhe pajisje larëse, tharëse dhe ngjyrosëse të flokut.
 - Manikinë të ndryshëm.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-